

ANASTAS
KONDO

BIBLIOTEKA
SHTETIT

84-32

k 87

Ata që do të
doja t'i kisha
shokë tërë
jetën

TREGIME DHE PËRSHKRIME

814-32019.93

K 87

ANASTAS KONDO

ATA QË DO TË DOJA T'I KISHA SHOKË TËRË JETËN



Trëgime dhe përshkrime

1705

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TREGIME

ËSHTE DIELL I FORTË E MË DJEG KAPTINËN...

Asnjë nuk ia dinte emrin e vërtetë. Ai ishte i internuari më i vjetër. E kishim gjetur atje dhe, si gjithë të tjerët, edhe ne, të internuarit e rinj, për forcë të zakonit, e thërrisnim po ashtu: Dajë.

Edhe Daja patjetër kishte emër, por ai ishte tashmë plak i vjetër e emri plakut nuk i duhet dhe aq shumë. Ka të tjera gjëra më të rëndësishme se emri për pleqtë në këtë moshë. Fjala vjen, shëndeti, vetë mosha, dua të them jeta që u ka mbetur e që përpiqen ta jetojnë me nder, ta mbyllin me kapak floriri, siç thoshte Daja. Në këtë çështje ai ishte merakli i madh. Vërtet i kishin mbetur pak vjet për të jetuar, se ishte mbledhur fort lëmshi, por, përsa i përket nderit, ai ishte aq i pasur në të, sa ia kishin zili të gjithë. Paçka se shorti i tij në pleqëri mbase nuk ishte për t'u lakmuar: patjetër që s'e kishte të lehtë i internuar në atë moshë. Por në këtë pikë plaku nuk bashkohej me mendimin e askujt që mund t'i vinte keq për të...

S'kishte filluar akoma Lufta italo-greke, kur mbërriti grupi ynë i të internuarve arsimtarë, që s'pranuam

të hynim në Partinë Fashiste. Askujt prej nesh nuk i kishte takuar më parë të gjendej apo dhe të kalonte aty pranë gadishullit të vogël në breg të detit Jon, ku ndodhej kampi i të internuarve politikë dhe ku gjëja më me vlerë, përveç të burgosurve, ishin Kalaja e Ali Pashë Tepelenës, Kisha e Vasiliqisë dhe iriqët e detit. I vë në një shkallë të trija këto gjëra krejt të ndryshme, sepse Kalaja e Ali Pashës i përkiste historisë dhe na kujtonte të parët tanë, Kisha e Vasiliqisë i takonte dashurisë dhe na sillte ndër mend gratë dhe të dashurat tona, kurse iriqët e zinj të detit kishin të bënin me të tashmen tonë. Të gjithë ne i përdornim iriqët për ushqim, se uria ishte zonjë e kampit. Kështu që iriqët dhe patelet, ca moluske petashuge me mish të pakët, që mbërthehen fort pas shkëmbinjve nënujorë, ishin ushqimi kryesor yni, i të gjithëve, me përjashtim të Dajës, që nuk i vinte në gojë, se ai nuk urrente asgjë më shumë se detin dhe mbretërinë e tij. «Mish deti, më keq se mish qeni», thoshte ai me përbuzje.

Nuk e di si e konsiderojnë veten fshatarët e Vrapit, (fshati nga ishte Daja); malësorë apo kodrinorë? Fshati i tyre male s'ka, por as fushë nuk ka. Ai ka disa kodra të zhveshura, që një fusharak mund t'i marrë për male dhe një malësor mund t'i marrë për bokërrima. Por bokërrimat mendoj që nuk janë male. Sidoqoftë, për një gjë ju siguroj që Daja kishte një merak gati prej myzeqari për tokën. Ishte vera, e dytë që ai vilte patatet e veta në ca gropë, që i kishte hapur me mundim të madh në shkëmbinj të karbonatikë të gadishullit. Gropat e plakut mund t'i numëroje me gishtat e njërës dorë dhe prodhimi i tyre matej me kokrra. Por, ç'është e vërteta, patatet bëheshin të mëdha, se plaku nuk e kursente plehun për to, dhe, po të punonim të gjithë ne të internuarit si Daja, mbase në atë gadishull pesëqind e ca metra të gjatë e afro treqind metra të gjerë, mund të rriteshin më shumë patate. Por të gj-

thë ne të internuarit ë tjerë nuk kishim asnjë dëshirë të mbillnim patate sot, që t'i vilnim mot, se ishim të rinj dhe nuk mendonim kurrë se ato patate do t'i hanim një ditë, përderisa shpresonim që një ditë do të iknim nga kampi. Se dihet që shtëpinë mund ta marrësh me tapi, po tapi për burgun nuk pranon kurrkush. Kurse plaku e kishte marrë shtruar internimin e vet, dhe nuk i shkonte mendja më njeriu se do të dilte një ditë nga kampi edhe plaku. Kështu mendonim ne, po plaku kishte mendim tjetër lidhur me këtë arsytim tonin. . .

Të krishterët e internuar, para se të kalonin në kaushat e Kalasë së Aliut, që, ca kohë përpara se të pushtohesh vendi nga Italia, vendasit i përdornin bukur fort edhe për kantina vere, duhej të bënin kryqin në atë rripin e tokës që lidhte gadishullin me kontinentin dhe ku bënte hije Kisha e vogël e Vasiliqisë. Në atë rrip toke, që matej me çape, ishte postblloku dhe kisha. Zakonisht, shumica e të internuarve ishin ateistë e besimtarë të këqij, me përjash-tim të ca fshatarëve vendas, që italianët i internuan në prak të luftës me Greqinë, me pretekstin se ishin agjentë të grekut. Këta ishin të vetmit, të paktën me sa pashë unë me sytë e mi, që bënin kryqin para se të hynin në ishkan-tinat e verës së tyre, dua të them, në kaushat e burgut të Ali fermanlliut, që i shërbente tani për këtë punë edhe mbretërisë së oksidentit levantin, Italisë. Për behar, në atë gadishull të gurtë, ku pëlçiste cinzuri nga vapa, këta kausha ishin të freskët, kurse në dimër ata ishin të ftohtë akull, me mure të qullëta, e në ditët më të mbara të pa-shallëkut të Aliut qenë përdorur edhe si frigorifer, ashtu siç i përdorën më vonë vendasit për kantina vere. . .

Sidoqoftë, historinë e Aliut Daja e vinte në kandar me atë të Esat Pashës në kohë të vet dhe, po t'i thoshte kush se Ali Pasha kishte luftuar shokët e Haxhi Qamilit, mund të merrte zët edhe pashën e Janinës, ashtu siç

urte edhe atë Toptanasin nga Tirana. Të tjerat në këtë kala nuk i hynin në qese dhe ai nuk mundohej të vriste mendjen për to.

Ai ishte një bujk i mirë, që shkante me fjalën e moçme: «në mos i hëngërsha vetë këto mbjella, do t'i hanë të tjerët». Këtë mësim donte të na jepte edhe neve plaku i urtë, më i moçmi nga ne të gjithë në moshë dhe më i vjetri në internim. Por në mësimin për patatet ne qëlluan nxënës të dobët të tij; për të tjerat nuk e pohoj dot këtë...

Si kishte ardhur Daja në këtë kamp? Pa dyshim që këtë pyetje e bëni dhe ju, se edhe ne që e gjetëm atje e u njohëm me të po për këtë gjë pyetëm në fillim. Më drejt: pse e kishin sjellë plakun aty? Se kuptohet që nga Vrapin në Porto Palermo zor se e gjente vetë rrugën plaku. Pra, ç'kishte bërë ai burrë shtatëdhjetëvjeçar nga fshati Vrap, diku aty pranë Peqinit, i imtë fare, një grusht njeri, që herëherë dukej sikur bashkë me brekushet e zeza peshonte më pak se qelesha e madhe, e lartë që kishte mbi krye? Ç'i kishte bërë «Italisë së madhe» ky plak i vocërr nga Vrap, që ajo ishte zemëruar aq shumë me të, sa e kishte degdisur në trojet e lashta të Kaonëve?

* * *

Ja ç'tregonin të tjerët për plakun nga Vrap.

Mbase shumë gjëra nuk ishin taman kështu. Daja as i kundërshtonte, as i pohonte ato që tregoheshin për të. Ai vetëm bënte sikur nuk dëgjonte. Por fakti që ai ishte një i internuar politik në kampin politik të Italisë, të bënte të besojë se shumica e gjërave që thuheshin ishin të vërteta. Ndoshta, disa detaje mund të qenë shtuar nga ata që tregonin për të, pa e fshehur simpatinë e tyre, por ato s'na prishin punë.

Një ditë prilli, herët, që me natë, Daja kishte vënë

përpara kafshën më të urtë të botës, hajvanin e vet, ngarkuar me dy koshat, ku blegërinin shelegët e njomë, e ishte nisur për pazar në Peqin. Kishte për të shitur dy shelegë të bardhë, si topa bore, se atë vit dhentë kishin qenë pëlleja të mbara. Por, meqë kishte një gjak borxh dhe hasmëri të fortë (ca tregonin me atë të barkut të Balajve, ca të tjerë me një fis tjetër) supit kishte hedhur një dogra të moçme turku, e vetmja pasuri që i kishte lënë trashëgim i ati. Se Peqini ishte kasaba e madhe dhe hasmi në vend pazari kishte qejf ta shkruhe me shumë, që të bënte ferk, ta merrte historia e t'i këndohej kënga. Dhe, që të mos i këndohej kënga vetëm hasmit të vet, Daja mbante në sup pushkën turke, që haku të merrej shqiptarçe, si burrat.

Po derisa të këndohej ajo këngë, rrugës dëgjoheshin blegërimat gazmore të shelegëve, që s'kishin vetëm kërcinj të dobët, por ishin dhe budallenj e s'e kuptonin për ç'kurbet i çonte Daja në Peqin. Herë-herë, kur mërzi tej nga blegërimat pa kuptim të shelegëve, që s'dinin ku shkonin, hajvani i mençur pëlliste fort, si t'u thoshte shelegëve: «Eh, more tuhafë, ç'ju gënjen mendja, që blegërinin kot së koti! Se ju do të shkoni, po s'do të vini më në Vrap, kurse unë shkoj dhe kthehem prapë. Paçka se tashti ju bëni qejf mbi kurrizin tim!».

Daja bënte sikur nuk e dëgjonte gjithë atë të pallur dhe nuk e godiste kafshën e urtë, që tani tregohej mendjemadhe. Nuk kishte arritur akoma në pazarin me nam të Peqinit dhe, si zakonisht, para se të shkonte atje, vajti të takonte një mikun e vet peqinas.

Mikun nuk e gjeti në shtëpi. Gruaja e mikut i tha:

— Im zot ka nisë rrugën për Durrës. Se i ka dalë hasmi.

Dihet ajo fjala e vjetër që thotë se hasmi i mikut tim është hasmi im. Këtë e vërtetoi dhe Daja atë minutë,

se i la shelegët pa shitur te gruaja e mikut e i tha asaj qetë:

— Hallall! i qoftë pushka! Po shkoj dhe unë me të.

Dhe u nis plaku në këmbë për në Durrës. Rruga ishte e gjatë dhe, me siguri, ai do të arrinte atje natën vonë e mikun e vet ose do ta gjente të vrarë dhe hasmi do të bënte ahëng në Durrës, ose mikun do ta takonte rrugës, tek kthehej shëndoshë e mirë nga Durrësi. Si njëra dhe tjetra nuk e nderonin vonimin e Dajës. Ca më tepër, tani rruga ishte e mërzitshme, sa s'kishte më blëgërima qengjash si fyej çobani e as të pallurën e fortë të hajvanit, si bori makine. Por s'mund të thuash se ishte fare pa fat plaku. Më të dalë të Peqinit, hasi në një kamion ngarkuar deng me të rinj, që shkonin edhe ata për në Durrës. Siç duket, kishin ndaluar atje për të marrë edhe ndonjë tjetër në makinë.

— Për ku udha e mbarë, çuna?, — i pyeti Daja djemtë.

— Në Durrës, xhajë, — i thanë djemtë shkollarë të Elbasanit. — Na ka dalë hasmi!

— Oul!, — u habit plaku. — Ç'po ndodh kështu, allahile? S'po e marr vesh. Edhe mikut tim në Peqin i ka dalë sot hasmi në Durrës, edhe juve ju paska dalë hasmi. Taksirat, bre çuna!... Thashë të qisja pushkë për të, po qis edhe për ju, — tha plaku, — se qenkeni të vegjël fort për pushkë.

— E, xhajë, — thanë çunat pa u prishur me plakun, — hasmi që ka dalë në Durrës është i gjithë shqiptarëve, jo vetëm i mikut tënd nga Peqini e as vetëm yni. Ai nuk do vetëm pushkën tënde e tonën, për të gjithë Shqipërisë...

— Ç'qenka ky baloz i madh kështu?, — pyeti plaku.

— Italia po na zaptton vendin, — thanë shkollarët me shpirtin plágë, — dhe ne shkojmë të luftojmë.

Ishte mëngjes herët i 7 Prillit të vitit 1939.

— Jo, mor!, — tha plaku. — Po pse, në duart tuaja mbeti kjo punë? Nuk paska zot Durrësi në Tiranë, që t'i dalë për mbrojtje?

— Ka ikur mbreti, xhajë. Ja mbathi! Dhe ne s'kemi armë. Themi mos gjejmë në Durrës, se në Elbasan na përcollën në të thatë.

— Tyt maskarai!, — tha plaku. — Por mbreti për kësi rastesh e ka vu hallku, që të mbrojtë vatanin. Hallall, çuna, një copë vend me ju, — iu lut plaku elbasanllinjve të rinj, që akoma s'kishin vënë brisk në faqe, dhe u ul e zuri vend në makinë.

Dhe e morën shkollarët pa pushkë të Elbasanit plakun me dogra të Vrapit dhe e çuan në Durrës.

Në Durrës luftonte kapter Mujo me skuadrën e vet të marinarëve vullnetarë. Daja deshi njëherë të kërkonte mikun nga Peqini, por u kujtua shpejt se nuk e gjente dot në atë gjendje alarmi e dyfeku që ishte qyteti. Shkollarët elbasanas ikën të gjenin armë, dhe plaku u nis andej nga dëgjohej se bëhej pushkë e madhe nga Mujo Ulqinakasi. Punonte akoma mitralozi i kapterit, që nuk iu bind mbretit, por vendit, dhe bënte luftë me një ushtri të tërë... Ishin kthyer dy herë këmbësorët e marinës së Italisë në anijet e tyre. Aeroplanat fluturonin mbi Kalanë e Durrësit, që tani mund të quhej kalaja e Mujos, dhe megafonat e fortë të marinës së huaj bënë zë të dorëzoheshin shqiptarët e paktë, që luftonin akoma te Kalaja e moçme e Durrësit dhe mbronin atë rrip toke të bregut, akoma më të moçëm se kalaja.

Plaku zuri vend midis bedenave të kalasë. Hoqi gjerdanin e fishekëve nga brezi dhe e siguroi mbi beden. I vuri fishekun në gojë pushkës dhe mori nishan mbi ushtarët e Italisë. S'ishte e zorshme për të të merrte nishan, se ushtarët e përtejdetit ishin mizë lisi. Ai zgjodhi

së pari njërin nga komandantët e varkave të shumta. Dhe komandantët ai dinte t'i dallonte: atyre u ndrisnin spatelat nga dielli i fortë. Plaku ishte plak dhe ndaj qëllonte shtruar, për merak e fishekët i harxhonte me kursim. Ai e mori vesh nga çunat e Elbasanit që asaj dite fishekët qenkëshin flori e nuk blekëshin dot as me themelet e shtëpisë.

Në fillim nuk e vuri re njeri plakun. Se marinarët e Mujos dhe ata të paktë vullnetarë të tjerë që kishin gjetur pushkë, kishin vetëm një hall: të vinin re mirë nga përpiqeshin të bënin këmbë bregut italianët. Por as plaku nuk kishte zënë vend atje midis bedenave, që ta vinin re shqiptarët. Ai kishte zënë vend atje, që plumbi i tij të rrokte mirë mishin e butë të italianit. Dhe vetëm kur një nga marinarët e Mujos dalloi që italianin, të cilit iu mat gjatë dhe i bëri benë, nuk e vrau pushka e tij, por e dikujt pranë, ktheu kokën të shihte se ç'ishte ky nishanlli që qëllonte aq bukur. Marinari i ri u habit. Pranë tij nuk ishte ndonjë shok i skuadrës, por një plak i vocërr me qeleshe të bardhë, të madhe si kovë, që anash ishte nxirë nga djersa dhe me një palë brekushe të zeza të rënda dhe opinga të lehta llastiku. Pushkën e kishte të rëndë ky plak dhe nishanin të madh, por dhe moshën e kishte të madhe, se buzëve i vareshin mustaqet e bardha dhe dhëmbë s'kishte hiç, e s'të besohej fare që do ta kishte vrarë ai italianin. Djalit të marinës i erdhi mirë që plaku ishte pranë tij. Mbase iu kujtua i ati!.. Ai deshi në fillim t'i thoshte: «Ik, se s'është vendi për pleq si ti këtu!», por tek e pa sa sevdalli qe plaku pas ushtarëve të Italisë, nuk i tha gjë, por i buzëqeshi si të qe i ati dhe kushedi, mbase, i tha me vete: «Aferim Dajë».

Plaku vazhdonte punën e vet dhe e hante merakun për mikun nga Peqini; a e kishte me këtë hasm të madh mërinë apo merrej me ndonjë çapaçul të hasmërisë së vje-